



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 105 Prot

Tiranë, më 05.07, 2011

VENDIM Nr. 164, dt. 05.07.2011

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 05.07.2011, mbasi shqyrtoi "Relacionin e ndryshimeve të propozuara në Projektin e Rikonstruksionit të rrugës Lezhë Kala – Lagjja Shehër, financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit,

VENDOSI:

- I. Të miratojë ndryshimet e propozuara nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Zyra e Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Lezhë, si më poshtë:
 1. Të ruhet fragmenti i murit fortifikues të Periudhës Helenistike (shek. IV – III p.e.s.) që intersekon rrugën në piketën 27.
 - a. Zgjerimi i rrugës të bëhet sipas përcaktimit në vend, deri tek blloku i dytë i murit, me rakordim në planimetri në përputhje me pjesën tjetër me gjerësi sipas projektit të rrugës.
 - b. Të shtrohet me kalldrëm segmenti i rrugës prej PK. Nr. 8 – PK.nr.27, duke përdorur të njëjtën teknikë si në pjesët e tjera të rrugës të shtruara me kalldrëm sipas projektit. Të bëhet kujdes që të ruhet dhe të jetë e dukshme pjesa e themelit të murit që aktualisht ndodhet në rrugën ekzistuese.
 - c. Të kryhet pastrimi i pjesës së tarracës ku ndodhet fragmenti i murit, nga vegetacioni, në të dy krahët dhe në pjesën e sipërme të tij.



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

2. Kroi "Hidrolez", burim natyror uji në piketën 38 ku gjatë punimeve për rikonstruksionin e rrugës u kryen pastrime nga bimësia, të cilat nxorën në dritë disa struktura sternash të vjetra ujëmbajtëse, qeramikë dhe u dalluan më qartë dy linja muresh.
 - a. Në krahun e majtë të Kroit zbresin dy linja muresh, ku blloqet e gurëve janë vendosur në të thatë. Të kryer spostimi i blloqeve paralelisht me murin e ri mbajtës, sipas një rakordimi, për të pasur një zgjerim të rrugës sipas projektit pa dëmtuar linjat e mureve të kroit.
 - b. Pjesa e djathtë e profilit të hapësirës së kroit të mbrohet me mur guri sipas tipit të përdorur në projekt.
 - c. Shtrimi me çakëll i sipërfaqes së pastruar të kroit.
 - d. Ndërtimi i një muri me gabion sipër kroit, për të siguruar mos-rënieën e blloqeve shkëmbore nga sipër.
3. Pranë Portës së Madhe midis piketave 44 – 45, të realizohet lidhja e Portës me rrugën me anë të një shkallareje guri, duke krijuar ndërprerje të shkallëzuar në murin pritës të rrugës.
4. Pjesa e rrugës me kalldrëm dhe hapësira e Parkingut lart në kodër pranë Kalasë Mesjetare
 - a. Pjesa e rrugës me kalldrëm të realizohet sipas projektit, nga fillimi deri te Parkingu, sipas propozimit në vend për vendndodhjen e re;
 - b. Në këtë pikë të ndërtohet sheshi i Parkingut sipas dimensioneve të përcaktuara në projekt.
 - c. Deri në hyrjen e Kalasë të vazhdojë shtrimi i rrugës me kalldrëm me seksion tërthor maksimumi 4.0 m gjerësi, sipas terrenit ekzistues (pra, pa kryer gërmime)
 - d. Fillimi i kalldrëmit të jetë me 3 – 4 shkallë 20 cm të larta për të evituar ngjitjen e mëtejshme të automjeteve, pas kësaj pike;



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- e. Të realizohet ndriçimi i ulët dhe dekorativ në këtë pjesë të rrugës;
 - f. Të eliminohen trotuaret dhe gjerësia e përgjithshme të jetë maksimumi deri në 4.0 m
 - g. Të bëhet shtrimi i sheshit me kalldrëm
 - h. Të bëhet rakordim i kalldrëmit me shtegun lidhës me urën që do të rikonstruktohet në hyrje të kalasë
 - i. Zëvendësimi i urës ekzistuese që hyn në Kala me një urë të re me hapësirë drite 3 m dhe gjerësi 2 m me veshje guri.
5. Në të gjitha pikat e rëndësisë së veçantë nga pikëpamja arkeologjike të vendoset sinjalistika shpjeguese suplementare në gjuhën shqipe dhe angleze.
- II. Punimet e zbatimit të projektit në pjesën e parkingut dhe rrugën që kalon mbi nekropol, të kryhen pas përfundimit të ekspeditës arkeologjike shqiptaro-franceze, mbështetur edhe nga ASHA.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve nga specialistë të ASHA në bashkëpunim me specialistë të Zyrës së Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Lezhë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

SUZANA TURKU

ZV. MINISTRE

SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRRIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al